



**KONTRATA SOCIALE
TIRANË**

**RAPORT MBI
MONITORIMIN E
PËRMBUSHJES SË
PRIORITETEVE**

GUSHT 2019 - GUSHT 2020

PËRGATITUR NGA:
QENDRA "ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM"



Suedi
Sverige



PROGRAMI: POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

Gusht 2019 – Gusht 2020

1



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim





Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorës,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamez;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec.

Ky Raport është Përgatitur nga Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” në kuadër të projektit POP 2020 “Monitorimi i zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e autorëve.



Tabela Përmbledhëse

Tabela Përmbledhëse	3
SHKURTIME.....	4
FALENDERIME.....	5
HYRJE	6
METODOLOGJIA.....	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	9
Gjetje nga informacioni i mbledhur në lidhje me 11 prioritete e Kontratës Sociale:	9
ANALIZA E GJETJEVE PËR SECILIN PRIORITET SIPAS KONTRATËS SOCIALE	11
Gjetjet nga monitorimi dhe informacioni I bashkisë Tiranë	11
Prioritet nr. 1:	11
Prioritet nr. 2:	12
Prioritet nr. 3:	13
Prioritet nr. 4:	14
Prioritet nr. 5	14
Prioritet nr. 6	15
Prioriteti nr. 7	17
Prioriteti nr. 8	18
Prioriteti nr. 9	19
Prioriteti nr.10	20
Prioriteti nr. 11	21
Gjetjet nga fokus grupet me komunitetin Tiranë	22
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	29
REFERENCA	30
ANEKSE	31

Shkurtime

NE	Ndihmë Ekonomike
NJA	Njësi Administrative
URB	Zonat Urbane
RUR	Zonat Rurale
GADC	Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillimi”
OJF	Organizata Jo-fitim prurëse
KB	Këshili bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministratave
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
POP	Përballja e Ofertave Politike
MKR	Mekanizmi i koordinuar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale
BTF	Bashki të Forta
COVID - 19	Pandemia e Virusit Korona
Kontrata Sociale	11 prioritetet kryesore të identifikuara nga qytetarët gjatë 2019
AZHRB	Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural
UKT	Ujësjetës Kanalizime Tiranë



Falenderime

Për të hartuar këtë raport gjatë kësaj periudhe të pazakontë për shkak të pandemisë COVID-19 bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë Bashkinë Tiranë dhe drejtoritë përkatëse për vënien në dispozicion të informacioneve të kërkuara; Kryetarin e bashkisë Z. Erion Veliaj dhe nën kryetaren znj. Anisa Ruseti për disponibilitetin e tyre për komunikime të vazhdueshme përgjatë vitit të parë monitorues.

Falenderojmë në mënyrë të veçantë qytetarët që pranuan ti përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) të cilët si ne po bëjnë një punë shumë të mirë pranë territoreve ku operojnë në ndihmë të komunitetit si edhe një falenderim për stafin dhe vullnetarët e Qendrës “Aleanca Gjinore për Zhvillim” të cilët që prej momentit të nënshkrimit të Kontratës Sociale kanë qenë në monitorim të vazhdueshëm të punës së bashkisë Tiranë dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **NED – National Endowment for Democracy** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohesh ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

5



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim





Hyrje

Gjatë vitit 2019 organizatat e Rrjetit POP zbatuan projektin "Përballja e Ofertave Politike - 2019 (POP 2019)" në 9 bashki të vendit, Tiranë, Durrës, Kukës, Pukë, Vlorë, Fier, Kamëz, Pogradec, Shkodër. Përgjatë vitit 2019 u arrit që të nënshkruheshin Kontrata Sociale të hartuara bazuar në prioritetet e komunitetit midis kryetarëve të rinj të bashkive dhe përfaqësuesve të organizatave anëtare të POP që veprojnë në bashkitë e sipër përmendura.

Gjatë vitit 2019, para dhe gjatë fushatës elektorale ne jemi fokusuar tek sjellja së bashku e grupeve lokale të qytetarëve në zonat urbane dhe rurale për të zgjedhur përparësitë e tyre dhe më pas prezantimit të përparësive të përzgjedhura dhe të përmbledhura në Kontrata Sociale për kandidatët në zgjedhjet vendore. Hartimi i Kontratës Sociale bëri që komuniteti të ketë një mjet për të mbajtur kandidatët e zgjedhur për Kryetar Bashkie dhe Këshillin e Bashkisë përgjegjës për adresim e tyre.

Forumet publike me komunitetin kanë adresuar çështjet e shërbimeve publike; qeverisja e mirë lokale; zhvillimi ekonomik lokal dhe dimensionin social. Kontakti i drejtpërdrejtë me qytetarët nga zonat rurale dhe urbane të përfshira në proces kontribuoi me propozime konkrete si prioritetet e komuniteteve të tyre.

Forumi për deklarimin dhe nënshkrimin e Kontratës Sociale¹ u organizua në datë 25 qershor 2019 dhe u finalizua me firmosjen e saj nga kryetari i bashkisë Tiranë, asokohe kandidat Z. Erion Veliqaj, i cili mori përsipër që prioritetet kryesore të pasqyruara në këtë kontratë dhe të dala nga komuniteti i Tiranës do të ishin përparësi edhe e punës së tij gjatë mandatit 2019 – 2023.

Gjatë vitit 2020 projekti vijoi me "Monitorimin e zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal." Gjatë kësaj faze të kësaj nisme POP synon që të llojë dhe të advokojë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve që janë nënshkruar në Kontratata Sociale për bashkitë: Tiranë, Kamëz, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Kukës, Pukë dhe Pogradec, gjithashtu synon përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje. Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioritetëve të kontratës sociale për periudhën gusht 2019 – gusht 2020.

¹ <https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2020/07/Tirana-Prioritetet-A3-Kontrata.pdf>



Kjo periudhë përfshin procesin e konsolidimit të qeverisjes vendore, njohjen me prioritetet e Kontratës Sociale, deklarimin publik të Kontratës Sociale në një takim të hapur me aktorët kryesorë vendore si dhe monitorim të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak dhe të zbatimit të prioritetëve të kontratës sociale.

Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” (GADC), për një periudhë të rëndësishme të vitit 2020, ka përshtatur aktivitetet për të ndjekur reagimin e pushtetit qendror e lokal si dhe problemet e komunitetit në përshtatje me protokollet e sigurisë.

Gjatë periudhës gusht 2019 - gusht 2020 organizata kishte si qëllim:

- Të prezantonte prioritetet e Kontratës Sociale dhe procesin e hartimit të tyre;
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioritetëve të Kontratës Sociale;
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llobojë dhe advokojë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve sidomos në kuadër të Dimensionit Social, Transparencës dhe Llogaridhënies.

Gjatë muajve mars – qershor 2020 fokus të vecantë iu kushtua menaxhimit të situatës COVID-19, vendimarrjes së Këshillit Bashkiak dhe menaxhimit të pandemisë nga Bashkia Tiranë²

Metodologjia

Për të realizuar raportin GADC, pjesë e rrjetit të POP u bazua në hapat si më poshtë:

- U monitorua puna e bashkisë Tiranë dhe vendimet e këshillit bashkiak për periudhën gusht 2019 – gusht 2020;
- U dërgua një letër-kërkesë me email për informacion drejtuesve të Drejtorive dhe Departamenteve përkatëse, sipas prioritetëve të Kontratës Sociale.

² <https://popnetwork.al/raporti-i-monitorimit-bashkia-tirane/>

- U organizua një takim online³ me nën kryetaren e bashkisë Znj. Anisa Ruseti, administratorë të njësive administrative dhe qytetarë të Tiranës mbi ecurinë e punës sa i përket përmbushjes së prioriteteve të komunitetit të Tiranës;
- U realizuan 10 fokus grupe me anëtarë të komunitetit në 10 njësi administrative të Tiranës, me pjesëmarrës të cilët kanë qenë pjesë e aktiviteteve të mëparëshme dhe kanë kontribuar në përcaktimin e prioriteteve të Kontratës Sociale.
- U monitorua në vazhdim puna e Këshillit Bashkia Tiranë, mbledhjet e organizuara para pandemisë si edhe mbledhjet e organizuara live në periudhën e mbylljes pandemike dhe më pas.
- U monitoruan vendimet e këshillit të bashkisë Tiranë.
- U realizuan disa takime me drejtues të Shërbimit të Mbrojtjes Sociale pranë kësaj bashkie, specifikisht me Drejtoreshën e Përgjithshme Znj. Anisa Subashi;
- U monitoruan takimet e ndryshme të përfaqësuesve të bashkisë përmes TV dhe medias sociale.
- U monitoruan vendimet e këshillit bashkiak në lidhje me masat e vetë bashkisë në lidhje me komunitetin në përgjithësi dhe me disa target grupe në veçanti, si dhe veprimtaria e anëtarëve të këshillit bashkiak.
- U analizua dhe monitorua buxheti i bashkisë për vitit 2019 – 2020 si dhe shpenzimet respektive bazuar në open data;
- U monitoruan dhe analizuan vendimet e KB që kanë lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale bazuar në punën e rrjetit POP apo edhe nga faktorë të tjerë të jashtëm, të tipit: parashikime të mëhershme në buxhet, plane afatshkurtra apo/dhe afatgjata, puna e organizatave të tjera të cilat mund të kenë ndikuar në përmbushje (organizata qeveritare, organizata ndërkombëtare me projekte apo edhe kombëtare).
- Analizimi i monitorimit të mediave audio vizive dhe on line në lidhje me sa më sipër sipas fushave specifike.

³ <https://popnetwork.al/takim-virtual-gadc-dhe-bashkia-tirane-kontrata-sociale-pop/>

Përmbledhje Ekzekutive

Në bazë të monitorimit të Bashkisë Tiranë, të kryer nga Qendra “Alenca Gjinore për Zhvillim” më poshtë renditen disa nga gjetjet kryesore të dala nga ky monitorim.

Gjetje nga informacioni i mbledhur në lidhje me 11 prioritetet e Kontratës Sociale:

- Në buxhetin e bashkisë Tiranë ka patur rritje për të rinjtë start-up, nga fondi 2.100.000 lekë me 20 përfitues dhe në fondin 5.000.000 lekë me 20 përfitues;
- Sipas Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, (AZHBR) nga data 29 maj deri 19 qershor 2020, fermerët kanë patur mundësinë të aplikojnë në e-Albania, me zero dokumente, për të përfituar nga fondet që jep buxheti i shtetit si mbështetje për sektorin bujqësor përmes Skemës Kombëtare 2020. Por, sipas takimeve me komunitetin, fermerët kryesisht janë vetfinancuar, nuk kanë bërë aplikime sepse ka shume kritere që sipas banorëve ata nuk kanë mundësi për ti plotësuar, konkretisht kërkohet sipërfaqe e madhe e tokës, të jetë me dokument pronësie etj;
- Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, ka njoftuar në mënyrë të vazhdueshme njësitë e qeverisjes vendore me përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standarteve të shërbimit veterinar, megjithatë në dy prej njërive të zonave rurale komuniteti vijon kërkesën për shtim veterinerësh;
- Në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.58 datë 26.12.2019 nuk janë parashikuar lehtësira për tarifat e taksave bashkiake për kategoritë në nevojë si gra kryefamiljare, apo vajza nëna.
- Gjatë periudhës monitoruese një vjeçare janë bërë disa ndërhyrje sa i përket çerdheve dhe kopshteve për fëmijë me rreth 8 godina te rikonstruara, ndërkohë që në njësitë administrative rurale nuk ka çerdhe dhe kopshtet janë pa ushqim;
- Ngritja dhe funksionimi i shërbimit rezidencial për të moshuar dhe persona që jetojnë në situatë rruge, target grup i vlerësuar si më vulnerabël, realizohet përmes Qendrës Sociale “Strehëza Tiranë”,
- Nga janari në qershor 2020, janë miratuar 2 vendime për përfitim Bonus Qiraje në Këshillin Bashkiak, ku janë shpallur fituese 41 gra,

- Është realizuar Inagurimi i Shërbimit Komunitar Lëvizës, Njësia Administrative Farkë në dhjetor 2019. Bashkia Tiranë në bashkëpunim me SOS Fshatrat në Shqipëri, kanë bashkëmodeluar dhe lancuar fillimin e ofrimit të shërbimeve lëvizëse sa më pranë familjes dhe anëtareve të komunitetit,
- Ndihma Ekonomike është dhënë brenda afatit të caktuar dhe nuk ka patur problematika apo ankesa nga përfituesit.
- Aktualisht, projekti më i ri që bashkia ka në qëllim për zbatim janë Klubet e Prindërimit, përmes të cilit, partnerë dhe ekspertë të fushës nga Save the Childen, Terre des hommes, World Vision dhe Bethany Social Services, do të mundësojnë module trajnime për prindërim pozitiv, duke shkuar pranë çdo komuniteti rural.
- Sa i përket shërbimeve për moshën e tretë në zonat rurale, Bashkia Tiranë është në proces të vlerësimit të aseteve të mundshme për të ngritur shërbime komunitare pranë zonave të ndryshme të njësive administrative rurale e në bazë të tyre të projektojë shërbimet e përshtatshme e planifikojë strukturat enevojshme shërbimofruese.
- Lidhur me prioritetet sipas Kontratës Sociale përsa i përket ndërhyrjeve sipas njësive administrative nr. 1, nr. 2, nr.3, nr. 5 dhe nr. 8, janë kryer 4 tipologji ndërhyrjesh kryesore: Ndërhyrjet me rikonstruksion; Ndërtimet e reja në objektet shkollore; Ndërhyrjet me “Mirëmbajtje të thellë” në tualete; Në sistemin e ngrohjes qendrore me kaldajë.
- Gjatë vitit të parë, pas firmosjes së Kontratës Sociale POP, nuk është ngritur asnjë bibliotekë e re. Kjo edhe për shkak të situatës së krijuar nga termeti dhe pandemia COVID-19 megjithatë Bashkia e Tiranës ka në fokus shtimin e numrit të bibliotekave.
- Që nga muaji Qershor 2020 përmes investimit të ri për zgjerimin e impiantit Bovillë dhe ndërtimit të linjave të reja të transmetimit është siguruar furnizim 24 orë për më shumë se gjysmën e kryeqytetit, në të cilën përfshihen plotësisht apo edhe pjesërisht disa njësi administrative. Sipas përlllogaritjeve të UKT-së, 62% e popullsisë së kryeqytetit ka aktualisht furnizim 24 orë në 24.
- Një prej prioriteteve të Kontratës Sociale ishte edhe shtimi i numrit të autobusëve sidomos për linjat e njësive administrative rurale Dajt, Baldushk dhe Farkë. Përballja me një situatë aspak të favorshme kjo për shkak të pandemisë COVID-19, ky prioritet nuk është përmbushur akoma.

Analiza e gjetjeve për secilin Prioritet sipas Kontratës Sociale

Gjetjet nga monitorimi dhe informacioni i bashkisë Tiranë

Prioritet nr. 1:

Shërbime veterinare në zonat rurale: Zgjerim i shërbimit veterinar në njësitë Baldushk, Dajt dhe Farkë.

Bashkia e Tiranës nëpërmjet Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit ka zbatuar me rigorozitet Ligjin 10465, datë 29.09.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” me qëllim kryesor, dhënien e një modeli për zbatimin e legjislacionit veterinar në fuqi, si faktori kryesor për sigurinë ushqimore dhe shëndetin e konsumatorit.

Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, bazuar në Ligjin 10465, datë 29.09.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, neni 54, VKM nr.230, datë 20.3.2013, “Për Përcaktimin e Funksioneve, Detyrave Specifike dhe Standarteve të Shërbimit Veterinar të Qeverisjes Vendore”, e cila qartëson teknikisht kompetencat e Shërbimit Veterinar në Njësitë e Qeverisjes Vendore, Sektori Veterinar ka kryer shërbimin veterinar si më poshtë vijon:

Strukturat veterinare në njësitë e qeverisjes vendore duhet:

- të bashkëpunojnë me strukturat e shërbimit veterinar rajonal për zbatimin e masave profilaktike, në rastin e fermave të regjistruara, si dhe për kufizimin dhe çrrenjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë;
- të përcaktojnë vendndodhjen dhe të administrojnë tregjet e kafshëve të gjalla;
- të përcaktojnë kullotat dhe vendet e pirjes së ujit, në varësi të situatës epidemiologjike dhe, nëse është e nevojshme, të ndalojnë përdorimin e tyre;
- të mbajnë nën kontroll dhe të zbatojnë legjislacionin në fuqi për eliminimin e qenve dhe maceve të rrugës;
- të kontrollojnë njësitë e shitjes së kafshëve të shoqërimit dhe zbukurimit;
- të organizojnë mbledhjen e kadavrave të kafshëve dhe të përcaktojnë vendet e proposjes ose të grumbullimit të tyre;
- të marrin masa për rrethimin dhe ruajtjen e pikave të grumbullimit të ujërave të zeza dhe të ndalojnë hyrjen e kafshëve atje;

- të kryejnë shërbimin veterinar në mjediset e thertoreve dhe të njërive të therjes, për kontrollin shëndetësor të kafshës para dhe pas therjes, vulosjen e karkasave të mishit dhe lëshimin e certifikatës veterinare, që shoqëron mishin dhe nënproduktet e tij;
- të njoftojnë autoritetin kompetent për sigurinë ushqimore për rastet kur në thertore konstatohen shkelje dhe parregullsi në respektimin e dispozitave të akteve nënligjore, si dhe të rregullave të zbatueshme.

Standardet e shërbimit veterinar të qeverisjes vendore dhe detyrat specifike për arritjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në vitin 2015 me ndarjen e re Administrative të Bashkisë Tiranë strukturat veterinare të Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit e zgjeruan veprimtarinë e tyre edhe në të gjitha Njësitë Administrative të territorit të Bashkisë Tiranë.

Referuar legjislacionit në fuqi është kryer shërbimi veterinar në thertore, janë monitoruar subjektet e tregëtimit të kafshëve të zburimit dhe shoqërimit, janë trajtuar qentë endacakë në të gjithë territorin e saj.

Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit referuar situatës së krijuar në qytetin e Tiranës duke vlerësuar shëndetin e konsumatorit si prioritet dhe detyrë funksionale, duke pasur qëllim kryesor, parandalimin e çdo rreziku eventual nga sëmundjet zoonotike ka kërkuar vazhdimisht bashkëpunimin e të gjitha strukturave aktuale që operojnë në fushën e veterinarisë dhe ushqimit, duke shfrytëzuar të gjithë mekanizmat e përshtatshëm ligjorë me qëllim, zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi, dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

Gjithashtu janë zbatuar edhe ndryshimet në ligjin nr.10465, datë 29.9.2011, "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar në datë 24.06.2020, në bashkëpunim edhe me strukturat qendrore të Shërbimit Veterinar.

Prioritet nr. 2:

Nxitja e biznesit të rinjtë, gratë dhe grupet vulnerabël: Zgjerimi i programeve ekzistuese me fokus të rinjtë dhe grate.

Për informimin e gjerë të grave dhe të rinjve mbi programet për nxitjen e biznesit dhe procesin e aplikimit për tu përfshirë, bashkia Tiranë, specifikisht Drejtoria për Nxitjen e Punësimit ka organizuar fushata informuese për projektet e kësaj drejtorie, referuar Udhëzuesit Operacional të miratuar në Këshillin Bashkiak. Fushata ka ofruar një prezantim të përgjithshëm të projektit, duke përdorur një qasje hap pas hapi ku aplikantët e interesuar informohen për kushtet e



përgjithshme të projektit, procedurat e aplikimit dhe kriteret e pranueshmërisë. Formulari i Aplikimit për Ide Biznesi të interesuarve u vihet në dispozicion gjatë takimeve informuese.

Zakonisht, takimet informuese organizohen në Sallën e Këshillit Bashkiak, udhëhequr nga koordinatori i projektit, dhe zhvillohen për të transmetuar informacionin e nevojshëm për të gjithë të interesuarit në një mënyrë të standardizuar.

Pjesëmarrësit në fushatën informuese njoftohen nëpërmjet thirrjes publike shpallur nga Sektori i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, postës elektronike, telefonatave dhe shpërndarjes në faqen zyrtare të bashkisë Tiranë, shoqëruar me formularin e aplikimit duke pasur si objektiv aplikantët e pranueshëm, të gjitha Ojft-të institucionet/partnerët që mund të informojnë aplikuesit që jetojnë në zonat urbane dhe rurale të Bashkisë së Tiranës.

Në buxhet ka patur rritje për të rinjtë start-up, nga fondi 2.100.000 lekë me 20 përfitues dhe në fondin 5.000.000 lekë me 20 përfitues.

Për krijimin e vendeve të reja të punës janë zhvilluar incentiva duke shpallur thirrje publike një herë në vit për Programet e Nxitjes së Punësimit, duke mbështetur bizneset ekzistuese dhe start-up me skema financiare (grante) për biznesin rinor, gratë sipërmarrëse dhe të rinjtë dhe të rejtat. Në këto incentiva janë integruar edhe persona me aftësi të kufizuara që për këtë periudhë monitorimi është vetëm 1 përfitues si edhe gra kryefamiljare apo vajza nëna, që për periudhën e monitorimit kemi 5 përfituese.

Prioritet nr. 3:

Mbështetja e fermerëve: Zhvillimi i programeve ekonomike që mbështesin fermerët – Njoftimi i tyre nga drejtoritë përkatëse në njësitë administrative dhe asistencë teknike dhe profesionale.

Sipas Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural⁴, (AZHBR) nga data 29 maj deri 19 qershor 2020, fermerët kanë patur mundësinë të aplikojnë në e-Albania, për të përfituar nga fondet që jep buxheti i shtetit si mbështetje për sektorin bujqësor përmes Skemës Kombëtare 2020.

⁴ <http://www.azhbr.gov.al/>



Fondi i parashikuar në Skemën Kombëtare 2020 është 743,9 milionë lekë dhe adreson financim të drejtpërdrejtë të fermerëve për sektorin e blektorisë, subvencionimin e çmimit të plastmasit, shtimin e sipërfaqeve të mbjella me bimë mjekësore dhe aromatike, çertifikimin e produkteve bujqësore, fermave organike, si dhe diversifikimin e aktiviteteve ekonomike në zonat rurale.

Masat e mbështetjes përmes Skemës Kombëtare janë komplementare me programin IPARD dhe nuk krijojnë mbivendosje me të.

Programi IPARD II 2014 – 2020 është mbështetje financiare për bujqësinë dhe zhvillimin rural nga fondet e BE-së (75%) dhe qeverisë shqiptare (25%).

Prioritet nr. 4:

Taksat bashkiake: Krijimi i lehtësive për tarifatat e taksave bashkiake për kategoritë në nevojë si gra kryefamiljare, invalidë të punës, persona me aftësi ndryshe, vajza nëna.

Në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.58 datë 26.12.2019 nuk janë parashikuar lehtësira sipas prioritetit të mësipërm. Sipas informacioneve të përfituara, pasi Bashkia Tiranë të bëjë një studim më të hollësishëm (si në grumbullim informacioni ashtu dhe në implementim) mund të parashikohen lehtësira për këto kategori në VKB-në e ardhshme.

Prioritet nr. 5

Kopshtet dhe çerdhet: Ngritja e kopshteve dhe çerdheve të reja në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Tiranë por sidomos në zonat rurale, në veçanti i çerdheve në Farkë dhe Dajt ku mungon plotësisht ky shërbim.

Gjatë periudhës monitoruese një vjeçare janë bërë disa ndërhyrje sa i përket çerdheve dhe kopshteve për fëmijë, specifikisht:

- Çerdhja 33 pranë njësisë administrative nr.5 – është marrë një ambjent i ri me dyfishin e kapacitetit;
- Çerdhja 34 "Çamaroket e Vegjel" pranë njësisë administrative numër 6;
- Çerdhja "Shtëpiza Magjike" në Kodër Kamëz, pranë njësisë administrative nr. 11;
- Kopshti "Masha dhe Ariu", njësia administrative Vaqarr;
- Kopshti 34 pranë njësisë administrative nr.6;
- Kopshti Kodër Kamëz pranë njësisë administrative nr. 11;

- Kopshti 62 Shkozë e Re, njësia administrative nr. 1 - për herë të parë hapet shërbimi me ushqim;
- Kopshti Sauk i Vjetër, njësia administrative nr.2 - për herë të parë hapet shërbimi me ushqim.

Në Njësitë Farkë dhe Dajt sipas informacionit të përfituar nuk ka patur ndonjëherë shërbim të tillë dhe vijon po njësoj. Në njësitë rurale ka vetëm kopshte që janë kryesisht të atashuara pranë shkollave dhe nuk ofrojnë ushqim.

Prioritet nr. 6

Zgjerimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për individët në nevojë

Ngritja dhe funksionimi i shërbimit rezidencial për të moshuar dhe persona që jetojnë në situatë rruge, target grup i vlerësuar si më vulnerabël, realizohet përmes Qendrës Sociale “Strehëza Tiranë”, si një shërbim i kompletuar që fillon me identifikimin në terren nga stafe të specializuara por dhe në bashkëpunim (Policia Bashkiake), ofrimin e asistencës së parë në vend duke vijuar me paketën e plotë të shërbimeve të kujdesit në strehëzën Tirana me higjenizim, veshmbathje, vakte ushqimore, kujdes shëndetësor, mbështetje psiko-sociale dhe orientim për shërbime të tjera sipas të drejtave.

Bashkia Tiranë trajton me prioritet në programet e strehimit social rastet e viktimave të dhunës në familje.

Nga janari në qershor 2020, janë miratuar 2 vendime për përfitim Bonus Qiraje në Këshillin Bashkiak, ku janë shpallur fituese 41 gra, nga të cilat 1 viktimë dhune dhe 1 viktimë trafikimi. Gjithashtu është bashkëpunuar mjaft mirë me OJF-te që kanë në fokus çështjet e dhunës në familje për të mbuluar pagesat e qerasë 2-3 muaj deri në momentin e përfundimit të procedurave të bonusit të qirasë. Ndërkohë nga Strehëza për Gra dhe Vajza, institucion anëtar i Mekanizmit, për periudhën janar-qershor 2020 janë trajtuar 17 gra dhe vajza si dhe 14 fëmijë.

Është realizuar Inagurimi i Shërbimit Komunitar Lëvizës, Njësia Administrative Farkë në dhjetor 2019. Bashkia Tiranë në bashkëpunim me SOS Fshatrat në Shqipëri, kanë bashkëmodeluar dhe lancuar fillimin e ofrimit të shërbimeve lëvizëse sa më pranë familjes dhe anëtarëve të komunitetit, dhe në kuadër të këtij bashkëpunimi Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Farkë ka vendosur në dispozicion për ofrimin e shërbimeve, ambiente pranë Njësisë Administrative Farkë, burimet njerëzore për zbatimin e suksesshëm të shërbimeve në kuadër shërbimeve me



bazë komunitare përmes qasjes së menaxhimit të rastit, informim, këshillim psikosocial dhe psikologjik, ndihmë direkte, programe passhkolle për fëmijët dhe të rinjtë, programin e prindërimit pozitiv, mobilimin e komunitetit etj.

Tjetër projekt i Bashkisë Tiranë është ai në Njësinë Administrative 7, është në proces finalizimi të një bashkëpunimi me Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS, për ngritjen e shërbimeve për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi, neglizhimi, dhuna dhe shfrytëzimi në Tiranë, por dhe të rinjtë dhe gratë, nëpërmjet një qendre komunitare multidisiplinare, me shërbime specifike si Shërbimi i emergjencës 72 orë dhe Shkolla e lëvizshme.

Gjithashtu, një risi për shërbimet sociale bashkiake që ofrohen në territoret e njësite administrative 1, 4, 6, 9, por që janë në funksion të mbarë komunitetit të qytetit të Tiranës, është edhe riorganizimi i Qendrave Sociale në Qendra Komunitare, duke mundësuar kohëzgjatje të shërbimit ditor përgjatë gjithë ditëve të javës, shërbime 8:00 – 20:00 dhe të shtunë 9:00-14:00.

Në lehtësim të përfitim në kohë të pagesës së ndihmës ekonomike, Bashkia Tiranë ka mundësuar lidhjen e një kontrate shërbimi me Postën Shqiptare, për kryerjen e shërbimit të pagesave për kategori të veçanta të përfituesve të ndihmës ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuar dhe pagesa shtesë për paketën e veçantë higjieno-sanitare për invalidët paraplegjikë e tetrapelgjikë, kostot e të cilit mbulohen nga buxheti vendor.

Ndihma Ekonomike është dhënë brenda afatit të caktuar dhe nuk ka patur problematika apo ankesa nga përfituesit.

Përfitimi i shërbimeve sociale në territoret rurale mbetet një sfidë për Bashkinë Tiranë, duke qenë se ende ka struktura shërbim ofruese në të gjitha këto komunitete, megjithatë nevoja është mbuluar me shërbimet e mundësuar nga OJF, partnerë të bashkisë, si nismën me Shkollën e lëvizshme dhe Shërbimi Komunitar Lëvizës, Njësia Administrative Farkë, në bashkëpunim me SOS Fshatrat në Shqipëri.

Aktualisht, projekti më i ri që bashkia ka në qëllim për zbatim janë Klubet e Prindërimit, përmes të cilit, partnerë dhe ekspertë të fushës nga Save the Children, Terre des hommes, World Vision dhe Bethany Social Services, do të mundësojnë module trajnime për prindërim pozitiv, duke shkuar pranë çdo komuniteti rural.

16



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile
Civil Society Development Center



qendra rinore e vlorës
V.Y.C.
vlorë youth center



Asociation for Intellectuals of Fond.Arcis



Young Intellectuals, Hope
IRSH
"Intelektualët e rinj, Shpresa"



Sa i përket shërbimeve për moshën e tretë në zonat rurale, Bashkia Tiranë është në proces të vlerësimit të aseteve të mundshme për të ngritur shërbime komunitare pranë zonave të ndryshme të njësive administrative rurale e në bazë të tyre të projektojë shërbimet e përshtatshme e planifikojë strukturat enevojshme shërbimofruese.

Ndërsa përsa i përket strehimit të familjeve që i prek projekti i Lanës dhe Unazës së madhe, mësohet se deri tek pallati me shigjeta është bërë një rivlerësim me Kartën Evropiane të Zhvillimit për sistemimin e këtyre familjeve. Janë parë të gjitha mundësitë që familjet të strehohen në të njëjtën zonë, në mënyrë që fëmijët të frekuentojnë të njëjtat çerdhe, kopshte apo shkolla. Për të gjitha rastet kur nuk ka patur mundësi akomodimi të menjëhershëm është vënë në dispozicion bonusi i qerasë.

Prioriteti nr. 7

Ngritja e shkollave të reja në njësitë administrative të bashkisë Tiranë

Gjatë periudhës së monitorimit gusht 2019 – gusht 2020 dhe bazuar edhe në informacionin e përfituar, janë bërë disa ndërhyrje sa i përket shkollave, specifikisht:

- Në Njësinë Administrative Baldushk, është ndërhyrë duke kthyer në funksionalitet shkollën 9-vjeçare “Fushas”.
- Në Njësinë Administrative Dajt ka përfunduar rikonstruksioni i shkollës së mesme të Bashkuar “Ymer Lala”. Aktualisht në këtë shkollë po zhvillohet në normalitet procesi mësimor.

Gjithashtu lidhur me prioritetet sipas Kontratës Sociale përsa i përket ndërhyrjeve sipas njësive administrative nr. 1, nr. 2, nr.3, nr. 5 dhe nr. 8, janë kryer 4 tipologji ndërhyrjesh kryesore:

- a) Ndërhyrjet me rikonstruksion;
- b) Ndërtimet e reja në objektet shkollore.
- c) Ndërhyrjet me “Mirëmbajtje të thellë” në tualete;
- d) Në sistemin e ngrohjes qëndrore me kaldajë;

Njësia Administrative Nr. 1:

- Në shkollën 9- vjeçare “Ali Demi”, është bërë ndërhyrje me rikonstruksion.
- Në shkollën 9-vjeçare "Androkli Kostallari " dhe në shkollën 9-vjeçare “Marie Logoreci”, është bërë mirëmbajtje e thellë e tualeteve.

Njësia Administrative Nr. 2

- Në shkollën 9-vjeçare "Hoxha Tasim" dhe në shkollën e mesme "Ismail Qemali", është bërë ndërhyrje me rikonstruksion.
- Shkolla 9-vjeçare "Kosova", është ndërtim i ri.
- Në shkollën 9-vjeçare "Osman Myderizi", është bërë mirëmbajtje e thellë e tualeteve dhe mirëmbajtje e thellë e sistemit të ngrohjes qëndrore me kaldajë.

Njësia Administrative Nr 3

- Në shkollën e mesme "Andon Z.Cajupi", është bërë ndërhyrje me rikonstruksion.
- Në shkollën 9-vjeçare "Hasan Prishtina" mirëmbajtje e thellë e tualeteve.

Njësia Administrative Nr. 5

- Në shkollën 9-vjeçare "Edith Durham", shkollën 9-vjeçare "At Zef Pellumbi", shkollën e mesme "Besnik Sykja", është bërë mirëmbajtje e thellë e tualeteve.

Njësia Administrative Nr. 8

- Në shkollën 9-vjeçare "Siri Kodra" është bërë ndërhyrje me rikonstruksion.
- Në shkollën 9-vjeçare "Shkolla e Kuqe", është bërë mirëmbajtje e thellë e tualeteve.

Në **aneksin nr.2** renditen në formë të tabeluar ndërhyrjet për të gjitha shkollat e bashkisë Tiranë si dhe tabela e investimeve përkatëse.

Prioriteti nr. 8

Ngritja e bibliotekave të lagjeve

Gjatë vitit të parë, pas firmosjes së Kontratës Sociale POP, nuk është ngritur asnjë bibliotekë e re. Kjo edhe për shkak të situatës së krijuar nga termeti dhe pandemia COVID-19 megjithatë Bashkia e Tiranës ka në fokus shtimin e numrit të bibliotekave.

Përsa i përket gjendjes aktuale, gjatë viteve të shkuara janë rikonstruktuar disa biblioteka të cilat janë:

Biblioteka "Musine Kokalari" - Njësia Administrative nr. 7

Biblioteka "Hamit Beqja" Njësia Administrative nr. 8

Biblioteka "Petro Zheji" Njësia Administrative nr. 9

Biblioteka "Mistro Treska" Njësia Administrative nr. 10

Ne proces rikonstruksioni:

Biblioteka Nr. 2 Njësia Administrative nr. 2

Biblioteka Nr. 7 Njësia Administrative nr. 11

Biblioteka Nr. 6 Njësia Administrative nr. 6

Godina e bibliotekës nr.6 ka dalë jashtë funksionit për shkak të tërmetit të nëntorit dhe gjatë vitit të ardhshëm do të shqyrtohet rehabilitimi i godinës dhe revitallizimi i bibliotekës. Bibliotekat nr 2 dhe nr 7 janë në fazën e mobilimit pasi procesi i rikonstruksionit të godinave ka përfunduar.

Prioriteti nr. 9

Zgjerim i programeve ndërgjegjëse në lidhje me dhunën në familje dhe pasojat e saj.

Vitet e fundit janë zgjeruar programet dhe aktivitetet ndërgjegjëse rreth dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore. Këtë vit, për shkak të situatës së shkaktuar nga COVID-19 dhe distancimit social, është organizuar një numër më i ulët aktivitetesh ndërgjegjëse me komunitetin, konkretisht 3 aktivitetete ndërgjegjëse në shkolla me një numër total prej 140 pjesëmarrësish.

Sa i përket rasteve të viktimave të dhunës është mundësuar identifikimi dhe trajtimi i një numri në rritje të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore përmes Mekanizmit të Koordinuar të Referimit Tiranë. Gjatë periudhës janar-qershor 2020, MKR Tiranë ka arritur të trajtojë 57 raste të dhunës në familje gjatë mbledhjeve të ETN-së dhe GTN-ve me anëtarë të MKR Tiranë, në bashkëpunim me Njësitë Administrative dhe Qendrat Komunitare. Këto 57 raste janë asistuar dhe trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Koordinatorja Vendore në Bashkinë Tiranë.

Në kuadër të prioritetit për zgjerimin e shërbimeve ekzistuese mbrojtëse për viktimat e dhunës në familje, gjatë muajit maj 2020 është nënshkruar një Marrëveshje e veçantë midis Bashkisë Tiranë dhe Linjës së Këshillimit për Gra dhe Vajza. Marrëveshja është lidhur për Fuqizimin e Linjës për Këshillimin e Grave dhe Burrave dhe viktimave të dhunës në familje, gjatë pandemisë së shkaktuar nga COVID-19. Qëllimi i kësaj marrëveshje është forcimi i Linjës së Këshillimit profesional me anë të telefonit për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë për mënyrat e menaxhimit të stresit, ankthit pas situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) Tiranë, i ngritur që në maj të vitit 2012, ofron shërbime multidisiplinare për të mbijetuarat/it e dhunës në familje dhe dhunës me bazë

gjinore, të tilla si, këshillim psikologjik dhe ligjor; asistencë pranë institucioneve: Gjykatë, Autoritetet e Policisë Vendore dhe Prokurori; aktivitete ndërgjegjësuëse dhe informuese të komunitetit; linjën telefonike 24 orëshe 116 117 pritëse, këshilluese dhe referuese të rasteve të dhunës në familje.

MKR Tiranë gjithashtu mundëson shërbimin e këshillimit për burrat dhe djemtë e dhunshëm nga Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem, anëtare e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit Tiranë. Ky shërbim synon reduktimin deri në ndalimin e plotë të akteve të dhunës, që ndjekësi i këtij programi kryen ndaj partneres apo familjarëve të tij.

Bashkia Tiranë u jep përparësi kërkesave për strehim social të viktimave të dhunës në familje si dhe i kushton rëndësi të veçantë fuqizimit social ekonomik të grave dhe vajzave vulnerabël dhe viktimave të dhunës në familje, me synim intgrimin dhe pavarësinë e tyre ekonomike. Në këtë kuadër, janë vendosur urat e bashkëpunimit me ofruesit e shërbimeve të formimit profesional si dhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë projekteve të nxitjes së punësimit, përmes granteve të financuara nga buxheti i Bashkisë, ku mund të përmendim projektin "Fuqizimi i Grave dhe Nxitja e Sipërmarrjes", përmes të cilit janë mbështetur kryesisht gratë kryefamiljare, gratë me aftësi të kufizuara si dhe gratë nga grupet e minoriteteve etnike.

Prioriteti nr.10

Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë dhe problemeve me kanalizimet e ujërave të zeza

Që nga muaji Qershor 2020 përmes investimit të ri për zgjerimin e impiantit Bovillë dhe ndërtimit të linjave të reja të transmetimit është siguruar furnizim 24 orë për më shumë se gjysmën e kryeqytetit, në të cilën përfshihen plotësisht apo edhe pjesërisht disa njësi administrative. Sqarohet se Ujësjellësi ka nëndarje zonale që nuk janë sipas njërive administrative por janë të organizuara sipas Burimeve, Depove shpërndarëse dhe rrjetit shpërndarës. Sipas përllogaritjeve UKT-së, 62% e popullsisë së kryeqytetit ka aktualisht furnizim 24 orë në 24.

Pjesa tjetër e kryeqytetit që ka furnizim direkt nga Selita dhe Shën Mëria kanë furnizim sipas regjimit të përcaktuar kryesisht tre herë në ditë.

Ujësjellësi i Tiranës garanton ujë cilësor sipas VKM nr. 379, datë 25/05/2016 si dhe në standardin BE 80/778. Çdo ditë përvec trajtimeve bazuar në protokollin e trajtimit të ujit që kryhen në Impiant apo depo shpërndarje, kryhen edhe analiza të kampioneve të ujit në rrjetin shpërndarës, si për parametrat fiziko-kimike ashtu edhe ato mikrobiologjike. Gjithashtu

20

sqarohet se uji në rrjetin shpërndarës është subjekt kontrolli periodik nga Inspektoriat Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) – për të garantuar kështu cilësi dhe siguri maksimale të ujit të pijshëm në rrjetin shpërndarës.

Një nga investimet që Ujësjiellësi ka kryer është dhe rikonstrukcioni i rrjetit shpërndarës pranë pallateve “Agimi” – ku janë ndërruar tubacionet e linjave të furnizimit.

UKT përveç investimeve të vogla dhe zgjidhjes së ofruar për linja të caktuara që lidhen me rrjetin e kanalizimeve në Tiranë, ka vënë në jetë dy investime shumë të rëndësishme që ofrojnë zgjidhje dhe lehtësim të administrimit të ujërave të ndotura në qytet:

1. Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve dhe kolektorëve përkatës me dimensione të mëdha përgjatë rrugës së Elbasanit – që japin zgjidhje për të gjithë zonën
2. Ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve dhe kolektorëve përgjatë të gjithë rrugës së Durrësit që me dimensione të mëdha – e cila mbledh ujërat e ndotura që nga rruga e Dibrës dhe rrugët rreth saj, deri te Rr. Egnatia – më parë këto ujëra mblidheshin në rrugën “Mine Peza” në kolektorët të ndërtuar në vitet ’40 për një popullsi shumë më të vogël se kjo e sotmja. Pra jep zgjidhje afatgjatë dhe ndikim pozitiv edhe në administrimin e ujërave të ndotura edhe në rrugët e përmendura nga ju.

Në zonën para konvikteve të Inxhinierisë së Ndërtimit, Ujësjiellësi ka investuar për të sistemuar problematikën e ujërave të ndotura për një pjesë të godinave të banimit si dhe të konvikteve të Inxhinierisë së Ndërtimit, pra rrjeti i kanalizimeve në zonë funksionon normalisht dhe nuk shfaq probleme.

Në njësinë administrative Farkë janë kryer ndërhyrje të ndryshme gjatë këtyre viteve me qëllim sistemimin e ujërave të ndotura. Drejtoria Rajonale UKT kujdeset si për furnizimin me ujë ashtu edhe për kanalizimet në Njësitë Administrative rurale të kryeqytetit.

Prioriteti nr. 11

Shtimi i autobusëve në linjat e njësive administrative

Një prej prioriteteve të Kontratës Sociale ishte edhe shtimi i numrit të autobusëve sidomos për linjat e njësive administrative rurale Dajt, Baldushk dhe Farkë. Por, përballja me një situatë aspak të favorshme kjo edhe për shkak të pandemisë COVID-19, sektori i transportit publik ka qenë një prej sektorëve më të prekur. Gradualisht është kthyer puna me kapacitet të plotë por nuk është implementimi i planeve të parashikuara për transportin publik. Flota e mjeteve të transportit rrethqytetas ku bëjnë pjesë edhe linjat prioritare është në një proces rinovimi që

nga viti 2017. Ndërkohë sa i përket informacioneve në vendqëndrimet e tyre për këto linja, ato janë në proces e sipër.

Gjetjet nga fokus grupet me komunitetin Tiranë

Paralelisht me monitorimin dhe mbledhjen e informacionit nga Bashkia Tiranë, GADC organizoi fokus grupe me komunitetin në 10 njësi administrative të kësaj bashkie, të njëjtat njësi në të cilat dolën edhe prioritetet kryesore. Në bazë të komunikimeve dhe gjetjeve prej tyre, qytetarët kanë identifikuar disa ndryshime positive të cilat janë pjesë e Kontratës Sociale, por kishte edhe prioritetet të cilat sipas tyre nuk janë përmbushur. Një pasqyrë e gjetjeve të këtyre takimeve paraqitet si vijon më poshtë, e ndarë sipas njësive administrative:

Njësia Administrative nr. 1

- Nevojë për rishikimin e taksave për kategorinë e nënave kryefamiljare – të cilat edhe nga gjetjet e bashkisë, nuk është mundësuar akoma;
- Megjithëse janë bërë disa ndryshime pozitive për çerdhet dhe kopshtet e fëmijëve, qytetarët shprehen se është i nevojshëm shtimi i numrit të tyre.
- Vijon të përsëritet kërkesa nga banorët për një qendër ditore për pensionistët në Rr. Ali Demi dhe kërkojnë më shumë vëmendje sa i përket implementimit të projektit të shërbimit në familje për të moshuarit e vetmuar.
- Sipas banorëve të kësaj njësie, është e nevojshme ngritja e bibliotekës, që edhe nga bashkia rezultoi si një prioritet i cili nuk është përmbushur këtë vit.
- Janë të mirëinformuar sa i përket ndërgjegjësisimit për të mos pranuar dhunën në familje por, kërkojnë banesa sociale apo zgjidhje të tjera që viktimat të mos jetojnë në të njëjtin shtëpi me dhunuesin.
- Furnizimi me ujë të pijshëm funksionon në rregull.

Shqetësime të tjera të ngritura nga qytetarët:

- Vendosja e sinjalistikës rrugore për këmbësorët pranë ish Uzinës Gjeologjike;
- Ndërhyrje në infrastrukturë për riparime në rrugët Idriz Dollaku, Millosh Shutku dhe Hafzi Sabri Koçi;
- Kërkesë llogarie nga bashkia drejtuar firmës së pastrimit për oraret e mbledhjes dhe heqjes së mbetjeve, sygjerohet në orët e para të mëngjesit apo orët e vona të mbrëmjes kur nuk ka këmbësorë në rrugë.

Njësia administrative nr. 2

- Pjesëmarrësit në takim janë të kënaqur me disa lehtësira nga tarifat e taksave vendore;
- Nevojë për kopshte dhe çerdhe;
- Nevojë për qendër shërbimesh për të moshuarit, mundësisht në të gjithë zonën;
- Janë të kënaqur me numrin e shkollave;
- Biblioteka është në rikonstruksion;

Shqetësime të tjera të ngritura nga qytetarët:

- Rruga lidhëse e Qemal Stafës me rrugën Hoxha Tasim ka nevojë për restaurim;
- Pranë shkollës Mihal Grameno, rruga Hekuran Mara ka nevojë për asfaltim;
- Ka rrjedhje uji në lagjen nr.2, rruga që del tek Mihal Grameno.
- Shqetësuese për banorët është fakti që pasi asfaltohet rruga, më pas bëhen ndërhyrje nga ujësjellësi apo ndërhyrje të tjera pas finalizimit;
- Kolektori i ujrave të zeza, rreth 55 metra ka mbetur i pa përfunduar.

Njësia administrative nr. 3

- Banorët shprehen se nuk ka patur më vonesa në shpërndarjen e ndihmës ekonomike;
- Në të dy shkollat e kësaj njësie është bërë ndërhyrje në rikonstruksion të tyre si edhe në tualete;
- Nevoja për kopshte është akoma prezente;
- Edhe këtë vit, mungon biblioteka që banorët e kanë kërkuar para një viti;
- Është bërë ndërhyrje sa i përket shtrimit të tubacioneve të reja të Ujësjellësit, por uji në shumë zona të kësaj njësie vijon të jetë me orare, tre herë në ditë;
- Kërkohet vëmendje e shtuar sa i përket pastrimit periodik dhe dizinfektimit të vendgrumbullimeve të mbetjeve nëpër lagje.

Njësia administrative nr. 4

- Banorët nuk kanë informacion dhe as dijeni nëse në këtë njësi ka një qendër shërbimi rezidencial për të moshuarit.
- Nga takimi me banorët rezulton që shkolla 9-vjeçare “Gjon Buzuku” ka rregulluar sistemin e ngrohjes qendrore dhe është funksional, megjithëse gjatë dimrit ka problematika me shumë prej kaloriferëve që sipas banorëve nuk janë të gjithë funksional ose nuk vihen të gjithë në punë;

- Dhuna ndaj grave dhe rritja e ndërgjegjësimit: Banorët shprehen që nuk kanë informacion sa i përket stukturave apo mekanizmave të ngritur pranë kësaj bashkie. E vetmja pikë kontakti ata mendojnë se është policia.
- Shtrimi i tubacioneve të reja të ujit është kryer gjatë vitit që lamë pas dhe ka përfunduar. Edhe kanalizimet kanë patur ndërhyrje nga bashkia, por ka zona, sidomos pallatet e vjetra të cilat shpesh herë bëhen burime ere nga kanalizimet e vjetra.
- Ndërkohë që ujë ka në mënyrë të rregullt 3 herë në ditë, por që përsëri edhe këtë vit banorët shprehen se uji nuk është i pijshëm dhe ata e blejnë ujin ose në markete ose me bote nëpër lagje, të cilat së fundmi janë rralluar. Pra ky prioritet vijon të jetë i paplotësuar për të patur ujë të pijshëm 24 orë.

Shqetësime të tjera të ngritura nga qytetarët

- Pastrimi i lagjeve pranë kësaj njësie lë shumë për të dëshiruar, nuk pastrohet rregullisht, por edhe kur punonjësit e pastrimit fillojnë punën, më së shumti gjatë kohës së paradites bëjnë një pastrim të përciptë dhe pa efekt;
- Koshat e mbledhjes së mbetjeve prej kohësh nuk po dezinfektohen edhe pse kohë pandemie dhe kjo sjell mbledhje të qenve endacakë dhe bëhet burim ere dhe infeksioni;
- Rrugët e brendshme nuk po mirëmbahen;
- Lulishtja tek zona afër TV Klan, që është premtuar vjet që do të mirëmbahet dhe do të vendoseshin stola, ka mbetur po njësoj;
- Administratorët e pallateve të vendosur nga bashkia, nuk bëjnë punën siç duhet për mirëmbajtjen e ambjenteve të përbashktë paçka që paguhen nga banorët në mënyrë të rregullt çdo muaj;

Njësia administrative nr. 5

- Taksat bashkiake janë në rregull, kanë përfituar lehtësira nga tarifat e taksave.
- Ka nevojë për kopshte dhe çerdhe shteterore pothuasje në të gjithë zonën e Njesisë nr.5.
- Ka nevojë për tu ngritur qëndër komunitare e cila është planifikuar për tu ndërtuar në zonën e Selitës.
- Ka nevojë për shkollë dhe po planifikohet të ndërtohet shkolla “Dritëro Agolli” në Selitë.
- Biblioteka nuk funksion sepse ambjenti është zënë nga ish pronarët.
- Furnizimi me ujë të pijshëm ka problem në rrugën Vaso Pasho, konkretisht nga Market Spar deri në fund të rrugicës. Tubacionet janë shtruar, por nuk është bërë lidhja, banorët kanë bërë disa herë kërkesë ndaj Bashkisë.

- Një shqetësim i ngritur nga banorët është për punëtorët e pastrimit të cilët i hedhin mbetjet në puseta.

Shqetësime të ngritura nga banorët.

- Pastrimi i brendshëm i lagjeve dhe lirimi i ambjenteve të përbashkëta, si tek pallatet nr. 23, 24, 26 dhe në lagjen Blloku i Vilave, poshtë Kristalit.
- Përballë tregut fruta -perime, në institucionin e minierave AKBN, gërmohen plehurat nga banorë të caktuar dhe bëhet i pamundur kalimi ndaj është e nevojshme ndërhyrja e bashkisë sa më parë;
- Tek rruga Petro Korçari të vendosen tabela për ndalim qarkullimi pasi banorët nuk arrijnë të futen dot në pallate, ose të vendoset tabela për resident;
- Tek rruga Mustafa Qose të vendosen polica të shtrirë në rrugë, pasi është pjesë e brendshme e lagjes dhe makinat kalojnë me shpejtësi, ose të vendoset sinjalistikë rrugore për ulje shpejtësie.
- Tek rruga Dora Distria parkimi i makinave të bëhet në një anë dhe të bëhen trotuare në këtë rrugë.

Njësia administrative nr. 7

- Janë hequr taksat vendore për kategoritë në nevojë, (taksat të përfshira në faturën e ujit) ndërsa për personat me aftësi të kufizuar dhe invalidet e punës, përfitojnë nga heqja e taksës vetëm nëse familjarët e tyre janë të papunë (e vërtetuar).
- Në lidhje me zgjerimin e programeve ndërgjegjësuere për dhunën në familje, janë rritur rastet e identifikimit të dhunës në familje, nëpërmjet informacioneve nga komuniteti, ndërveprimi ndërlidhës me komunitetin - SPZ, si dhe nga urdhërat e mbrojtjes.
- Viktima e dhunës në familje trajtohen me ndihmë ekonomike sipas legjislacionit të ndihmës ekonomike për këtë kategori, ndihma ushqimore, apo ndërmjetësime të ndryshme me institucionet apo OJF sipas prioritetit të problematikës.
- Të hiqet edhe taksa e ndërtesës për familjet në të cilat kryefamiljari është invalid pune ose me aftësi të kufizuara dhe që nuk kanë të ardhura të tjera përveç pagesës së paaftësisë.
- Në lidhje me strehimin, qoftë për gratë e dhunuara, qoftë për kategoritë e tjera në nevojë që duhet të aplikojnë për strehim (bonus qeraje, etj.) problem janë pronarët e banesave të cilët nuk lidhin ligjërisht kontratën e qerasë, ndërmjet tyre dhe qeramarrësit. Mungesa e kontrates së qerasë sjell pengesa ligjore jo vetëm në plotësimin e dosjes për të përfituar bonusin e qerasë, por edhe për aplikim për ndihmë ekonomike dhe shërbime të tjera të përkujdesit shoqëror.

Shqetësime të ngritura nga banorët.

- U kërkua mirëmbajtja e ambienteve sportive dhe menaxhimi më i mirë i tyre.
- U kërkua mirëmbajtja e lulishteve dhe shërbimet ndaj pemëve (vadtja, krasitja etj.) dhe shtimi i numrit të stolave.
- U ngrit problemi i ndërhyrjes në rrugën në fillim të fushës së aviacionit për arsye se është burim aksidentesh.
- U kërkua hapja e një zyre postare dhe e një qendre shëndetësore në zonën e fushës së aviacionit.

Njësia administrative nr. 8

- Kapacitet dhe infrastruktura për shkolla dhe çerdhe janë në rregull;
- Furnizimi me ujë të pijshëm është në rregull;
- Janë shtruar rrjetet e reja të ujësjellësit si dhe sahatët matës;
- Janë informuar mbi programet e nxitjes së biznesit dhe procesin e aplikimit për t'u përfshirë në këto programe;
- Ka shumë lehtësira përsa i përket tarifave të taksave bashkiake kryesisht pensionistët, familjet që janë përfituese të ndihmës ekonomike si dhe personat me aftësi të kufizuara;
- Është e rëndësishme për këtë njësi ngritja e një qendre të re sociale që ka në tërësi të gjitha shërbimet e komunitetit, si nga ngrënia e deri tek shërbimet shëndetësore për të gjitha grupmoshat. Gjithashtu duhen shërbime për target grupin e fëmijëve me aftësi ndryshe.
- Është shumë e nevojshme prania e një punonjësi social që mund të ofrojë shërbim psikologjik në familje, sidomos tek fëmijët.

Shqetësime dhe kërkesa të tjera nga qytetarët

- Ngritjen e një qendre më vete ku në qendër të jenë fëmijët me aftësi të kufizuara, sygjerohet për shtim stafi tek njësia e Bregut të Lumit. Duke qenë se qendrat aktualisht janë në varësi të Bashkisë duhen shtuar më shumë shërbimet.
- Të ofrohen terapi në qendrat që kanë persona me aftësi të kufizuara, pak a shumë si qendra Gonxhe Bojaxhi.
- Mungesa e një qendër ditore për fëmijët autik sakrifikon punën e njërit prind për të mbajtur fëmijën e tij dhe ky është një problem kryesor për këto familje.
- Njësitë vendore të bëjnë më shumë verifikime në terren, pasi banorët kanë probleme me lidhjen e kontratës së qerasë me pronarët e shtëpisë.

26



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



CSDC
Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile
Civil Society Development Center



qendra rinore e vlorës
V.Y.C.I.
vlorë youth center



HIZI
Asociation for Intellectuals of Fond.Arcus



Young Intellectuals, Hope
IRSH
"Intelektualët e rinj, Shpresa"



lëvizja rinore
për demokraci



Center for
Youth Progress
Y.P.



rias



ER

- Kërkoheq që të hiqet vërtetimi i shkollës që merret për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe e dorëzon tek njësia çdo tre muaj, dhe të gjendet mundësia të merret online.
- Problematika në pallatin e beqarëve, kërkoheq ndërhyrje dhe ndihmë.

Njësia administrative Baldushk

- Qytetarët e kësaj njësie bëjnë përsëri kërkesë për të patur 2 veteriner të cilët mungojnë;
- Fermerët kryesisht janë vetfinancuar, kanë patur ndihmë nga AZHBR, por nuk kanë bërë aplikime sepse ka shume kritere që sipas banorëve ata nuk kanë mundësi për ti plotësuar, konkretisht kërkoheq sipërfaqe e madhe e tokës, të jetë me dokument pronësie etj.
- Banorët kërkojnë sistem vaditje në mynyë emergjente dhe treg fruta -perime ku të shiten produktet buqësore.
- Sipas banorëve, subvencionet nuk kanë funksionuar për këtë zonë, kërkoheq ulje e çmimeve të imputeve bujqësore.
- Ka nevojë për kopësht me drekë fshati Mustafakoç, aktualisht nuk ka asnjë dhe një kënd lojrash për fëmijë.
- Kërkoheq shërbime rezidenciale për të moshuarit.
- Furnizimi me ujë të pijshëm ka e gjithë zona, banorët furnizohen me ujë pusi. Ndryshime apo përmirësime nuk ka patur. Linjat me tubacione janë të vendosura por nuk ka burim të ujit. Kanalizimet e ujërave të zeza kanë probleme në zonën Mustafakoç.
- Nevojitet linjë autobuzi në Fshatin Koçaj, Vesia dhe Kokuja. Kërkoheq shtim orari për zonën në funksion.

Njësia administrative Dajt

- Shërbimi veterinar funksionon;
- Nevojitet treg fruta - perime që të funksionojë me orar të reduktuar, të paktën dy orë në ditë;
- Te rinjtë dhe gratë punësohen në bizneset e tyre më së shumti;
- Lagjia Lanabregas ka nevojë për kopësht, çerdhe dhe shkollë, aktualisht nxënësit shkojnë në Surrel;
- Një shqetësim i ngritur nga banorët është për ndërhyrje në infrastrukturë dhe rregullimin e ujit te pijshëm konkretisht në: Rruga lidhëse midis Linzës dhe Tufinës duhet restauruar si edhe uji i pijshëm ka probleme; Priska ka nevojë për ndërhyrje me

rrugët gjithashtu, probleme me ujën e pijshëm; Lagjia Selba ka nevojë për tu rregulluar rruga me çakull;

- Transporti publik funksionon në rregull.

Njësia administrative Farkë

- Banorët ribëjnë kërkesë për veteriner;
- Fermerët kryesisht janë vetëfinancuar, kanë patur ndihmë nga AZHBR, por nuk kanë bërë aplikime sepse sipas tyre ka shumë kritere që banorët nuk kanë mundur ti plotësojnë;
- Ka patur mbështetje nga SOS, janë ofruar shërbime të ndryshme por nuk ka patur interes nga banorët;
- Ka nevojë për kopësht me drekë dhe çerdhe, aktualisht nuk ka asnjë;
- Furnizimi me ujë të pijshëm është me orar të reduktuar, kërkohet kohëzgjatje. Ndryshime apo përmisime nuk ka patur.
- Kanalizimet e ujërave të zeza kanë probleme në zonën Farkë e Vogël, Farkë e Madhe dhe Mjull Bathore;
- Nevojitet linjë autobuzi në Mjull Bathore dhe Lundër.
- Në zonën Farkë e Vogël dhe Farkë e Madhe kërkohet shtim orari, pasi aktualisht është deri në orën 18:00 dhe vjen një herë në orë, pra të shpeshohen oraret.

Përfundime dhe Rekomandime

Prioritetet e Kontratës Sociale për Tiranën janë relevante dhe të arsyeshme. Gjatë këtij monitorimi në periudhën gusht 2019 – gusht 2020 u vu re një lëvizje pozitive nga ana e bashkisë për të përmbushur disa prej prioriteteve të dala nga qytetarët e Tiranës. Por, megjithatë, gjatë këtij monitorimi doli në pah që tërmeti i madh i 26 nëntorit 2019 si edhe situata pandemike e cila është aktuale që prej muajit mars 2020, ktheu vëmëndjen e bashkisë drejt prioriteteve më emergjente sa i përket rindërtimit dhe menaxhimit të situatës pandemike COVID-19.

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” do të vijojë përsëri monitorimin e punës së bashkisë, drejtorive përkatëse si edhe vendimeve të Këshillit Bashkiak pranë kësaj bashkie, dhe bazuar në Kontratën Sociale listojmë si vijon më poshtë rekomandimet kryesore:

- Parashikimi në buxhetin e bashkisë për vitin 2020 për mirefunksionimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit;
- Rishikimi i lagjeve, apo njësive administrative ku ana infrastrukturore e rrugëve, trotuareve apo sinjalistikave mungon;
- Kthimin e vëmëndjes në njësitë administrative rurale sa i përket kërkesave të banorëve për ndërtim çerdhesh për fëmijë apo kopshtesh me ushqim;
- Furnizimi me ujë të pijshëm 24 orë nga masa 62 % që është aktualisht në masën 100 % si edhe bërja publike me anë të fushatave që nëse uji është i pijshëm, banorët e Tiranës të ndalojnë blerjen e tij;
- Ngritja e bibliotekave sipas njësive administratie dhe sipas kërkesave të banorëve;
- Rishikimi i menaxhimit të punës sa i përket kanalizimeve të ujërave të zeza në disa zona të ndryshme të Tiranës;
- Rritje e kërkesës së llogarisë kompanive të pastrimit të mbetjeve nëpër Tiranë;
- Të rishikohen marrëveshjet e bashkëpunimit me kompanitë e transportit në mënyrë që shërbimi të ofrohet në orare më të shpeshta dhe me shtim flote, sidomos për njësitë administrative rurale;
- Të shikohen me përparësi prioritetet e papërmbushura në terësi dhe në veçanti si edhe shqetësimet e ngritura nga komuniteti gjatë takimeve të fundit të realizuara gjatë periudhës gusht - shtator 2020



Referenca

Faqja zyrtare e bashkisë Tiranë <https://www.tirana.al/>

Faqja zyrtare e Kryetarit të bashkisë <https://www.facebook.com/ErionVeliaj>

Kontrata Sociale Tiranë <https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2020/07/Tirana-Prioritetet-A3-Kontrata.pdf>

Takime me Shërbimin Social <https://popnetwork.al/aleanca-gjinore-per-zhvillim/>

Takim me nën kryetaren e bashkisë Znj. Anisa Ruseti <https://popnetwork.al/takim-virtual-gadc-dhe-bashkia-tirane-kontrata-sociale-pop/>

Takime me komunitetin <https://popnetwork.al/takime-me-komunitetin-e-bashkise-tirane/>

Vendime të Këshillit bashkiak <https://www.vendime.al/tirane/>

Open data: http://spending.data.al/en/treasury/list/year/2019/inst_code/2101001

30



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile
Civil Society Development Center



- qendra rinore e vlotës
V.Y.C.I.
- vlora youth center



Association for Integration of Gender Issues



Young Intellectuals, Hope
IRSH
"Intelektualet e rinj, Shpresa"



Anekse

Aneks 1. Kontrata Sociale e detajuar

KONTRATA SOCIALE PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE PRIORITETET E KOMUNITETIT BASHKIA TIRANË

Prioriteti 1: Shërbime veterinare në zonat rurale: Zgjerim i shërbimit veterinar në njësitë Baldushk, Dajt dhe Farkë.

Prioriteti 2: Nxitja e biznesit të rinjtë, gratë dhe grupet vulnerabël: Zgjerimi i programeve ekzistuese me fokus të rinjtë dhe gratë :

- Informimi i gjerë i grave dhe të rinjve mbi programet për nxitjen e biznesit dhe procesin e aplikimit për tu përfshirë në këto programe.
- Rritje e buxhetit për start -ups për të rinjtë, i cili rrjedhimisht nënkupton rritje të numrit të perfituesve.
- Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës;
- Identifikimi i personave me aftësi të kufizuara, grave kryefamiljare apo vajzave nëna dhe integrimi përmes këtyre incentivave.

Prioriteti 3: Mbështetja e fermerëve: Zhvillimi i programeve ekonomike që mbështesin fermerët – Njoftimi i tyre nga drejtoritë përkatëse në njësitë administrative dhe asistencë teknike dhe profesionale.

Prioriteti 4: Taksat bashkiake: Krijimi i lehtësive për tarifën e taksave bashkiake për kategoritë në nevojë si gra kryefamiljare, invalidë të punës, persona me aftësi ndryshe, vajza nëna.

Prioriteti 5: Kopshtet dhe çerdhet: Ngritja e kopshteve dhe çerdheve të reja në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Tiranë por sidomos në zonat rurale, në veçanti i çerdheve në Farkë dhe Dajt ku mungon plotësisht ky shërbim.

Prioriteti 6: Zgjerimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për individët në nevojë, në njësitë vijuese:

Të gjitha njësitë:

- Ngritje e shërbimit rezidencial për të moshuarit.
- Trajtim me prioritet me strehim social të familjeve që jetojnë në bodrume dhe të grave të dhunuara.

Njësia 2, 5, 7 dhe Farkë : Ngritja e një qendre komunitare për kategoritë në nevojë.

Njësia 3: Shmangia e vonesave në shpërndarjen e ndihmës ekonomike, si dhe mbështetja me më shumë shërbime e familjeve në ndihmë ekonomike, në mënyrë të veçantë përmes strehimit social. Ngritja e një qendre ditore për të moshuarit.

Njësia 7: Zgjidhje afatgjatë e strehimit për banorët që preken nga projekti i Lanës dhe Unazës së Madhe.

Njësitë rurale: Krijimi i aksesit tek shërbimet sociale të ngritura nga Bashkia; Shërbime për moshën e tretë.

Prioriteti 7: Ngritja e shkollave të reja në njësitë administrative nr. 1, nr.2 (Në zonën e Depos së Ujit në rrugën "Budi"), nr.3, nr.5, nr.8 (në shkollën Skënder Çaçi vijon mësimi me dy turne dhe nga 33 veta në klasë), Baldushk (Ka fshatra që janë larg dhe fëmijet e kanë vështirë të shkojnë deri në qendër), Dajt (Mungon shkolla e mesme. Shkolla e mesme më e afërt është 1 orë larg). Planifikimi për të rregulluar sistemin e ngrohjes dhe të tualeteve në çdo shkollë 9-vjecare apo të mesme.

Prioriteti 8: Ngritja e bibliotekave të lagjes në njësinë 1,3 dhe 5 si edhe në zonat rurale.

Prioriteti 9: Zgjerim i programeve ndërgjegjësuere në lidhje me dhunën në familje dhe pasojat e saj. Rritje e identifikimit të rasteve të dhunës në familje përmes punës proaktive në komunitet të strukturave të shërbimeve sociale; Forcimi i rrjetit të policimit në komunitet dhe nderlidhsave me komunitetin. Zgjerim i shërbimeve ekzistuese mbrojtëse, fuqizuese dhe ri-integruese për viktimat e dhunës në familje.

Prioriteti 10: Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë dhe problemeve me kanalizimet për secilën prej njësisive vijuese:

Njësia 1: Zgjidhja e furnizimit me ujë me prioritet për zonat ku uji shkon vetëm 1 herë në ditë. Masa për të shmangur bllokimin e kanalizimeve.

Njësia 2: Prioritet rruga "Budi" ku uji lëshohet në orën 7 të darkës dhe vetëm për dy orë. Gjithashtu uji është i pakonsumueshëm. Zgjidhje për kanalizimet në këtë njësi. (Erë e padurueshme që vjen si pasojë e kanalizimeve të pa rregulluara.)

Njësia 3: Furnizim me ujë të pijshëm në të gjithë njësinë njësoj si në Kodrën e Priftit që furnizohet me ujë pa ndërprerje. Ndërhyrje për kanalizimet veçanërisht në rrugët më problematike “Ali Bahushi”, “Kongresi i Manastrit” dhe “Kujtim Laro”.

Njësia 4: Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit. (Aktualisht furnizimi tre herë në ditë, më orare dhe nuk është i përdorshëm për tu pirë.)

Njësia 5: Ndërhyrje tek Pallatet “Agimi”, në kufi me rrugën “Brigada e 8-të” ku tubacionet e ujit janë të vjetra.

Njësia 7: Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit. (Ujin e pijshëm banorët e blejnë.). Zgjidhja e rrjedhjes së ujrave të zeza para konvikteve të Inxhinierisë së Ndërtimit, ujëra që zbresin deri tek fusha e aviacionit.

Njësia 8: Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit. Ndërhyrje në kanalizimet e rrugës “Ferit Xhajko”. (Pallati 59/8 vuan nga era e padurueshme që vjen si pasojë e kanalizimeve të pa rregulluara. Problem ekzistues prej 30 vjetësh.)

Njësia Baldushk: Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit. (Disa prej banorëve përdorin pusët e tyre. Uji që vjen nuk është i pijshëm.)

Njësia Dajt: Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit. (Nuk ka ujë të vazhdueshëm, vjen me orare, përdoren depozita edhe pse është zona e ujit të burimit. Uji bëhet i pa pijshëm. S’ka furnizim 24 orë.)

Njësia Farkë: Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit me prioritet lagjia “Dina” dhe “Farkë e Vogël”. Zgjidhje e problemit të derdhjes së ujrave të zeza në tokat e banorëve.

Prioriteti 11: Shtimi i autobuzëve në linjat e njësive administrative Baldushk, Dajt dhe Farkë. Publikimi në stacion i orareve të mbërritjes dhe nisjes së autobuzëve.

Aneks 2 – Investimet në shkolla

Në vazhdimësi jepet tabela e datajuar me ndërhyrjet me “Mirëmbajtje të thellë” në tualete dhe në sistemin e ngrohjes qendrore me kaldaje, gjithashtu ndërhyrjet me rikonstrukcion dhe ndërtimet e reja në objektet shkollore sipas Njësive Administrative të Qytetit të Tiranës.

Nj.A	Objekti	Nderhyrje me rikonstrukcion	Ndertim I ri	Mirëmbajtje e thellë e tualeteve	Mirëmbajtje e thellë e sistemit të ngrohjes qëndrore me kaldajë
Njesia Administrative Nr.1	Shkolla e Mesme "Abdulla Keta"				
	Shkolla 9-Vjecare "Ali Demi"	+			
	Shkolla 9-Vjecare "Kushtrimi i Lirise "				
	Shkolla 9-Vjecare "1-Maji"				
	Shkolla 9-Vjecare "Androkli Kostallari "			+	
	Shkolla 9 - vjecare "Marie Logoreci"			+	
Njesia Administrative Nr.2	Shkolla e Mesme "Ismail Qemali"	+			
	Shkolla e Mesme "Sander Prosi"				
	Shkolla 9-Vjecare "Fan Noli"				
	Shkolla 9-Vjecare " Mihal Grameno"				
	Shkolla 9-Vjecare " Hoxha Tasim "	+			
	Shkolla 9-Vjecare "Osman Myderizi"			+	+
	Shkolla 9-Vjecare "Mustafa Greblleshi"				
	Shkolla 9-Vjecare "Qemal Ataturk "				
	Shkolla 9-Vjecare "Ibrahim Brahja "				
	Shkolla 9-Vjecare "Kosova "			+	

	Shkolla e Mesme "Asim Vokshi"				
	Shkolla e Mesme "Jordan Misja"				
	Shkolla e Baletit				
Njesia Adm. Nr.3	Shkolla e Mesme "Andon Z.Cajupi"	+			
	Shkolla 9-Vjecare "Hasan Prishtina "			+	
	Shkolla 9-Vjecare "Xhezmi Delli "				
	Shkolla 9-Vjecare "Kongresi i Lushnjes"				
	Shkolla 9-Vjecare "Nikit Dardan"				
Njesia Adm Nr.4	Shkolla e Mesme "Eqerem Cabej"			+	
	Shkolla 9-Vjecare "Gjon Buzuku"			+	
	Shkolla 9-Vjecare "Ramazan Jarani"				
	Shkolla 9-Vjecare "Bajram Curri "			+	+
	Shkolla 9-Vjecare " Pal Engjell1"				
	Shkolla 9-Vjecare " Ardian Klosi"		+		
Njesia Administrative Nr.5	Shkolla e Mesme "Besnik Sykja"			+	
	Shkolla e Mesme "Petro N. Luarasi"				
	Shkolla 9-Vjecare "Deshmoret e Lirise"				
	Shkolla 9-Vjecare "Edith Durham"			+	
	Shkolla 9-Vjecare "Emin Duraku"				
	Shkolla 9-Vjecare "26-Nentori"			+	
	Shkolla 9-Vjecare "Vasil Shanto"				

	Shkolla 9-Vjecare "Murat Toptani "			+	
	Shkolla 9-Vjecare "At Zef Pellumbi "			+	
Njesia Adm Nr.6	Shkolla e Mesme " Myslym Keta "			+	+
	Shkolla 9-Vjecare " Lasgush Poradeci "				
	Shkolla 9-Vjecare "Shyqyri Peza "				
	Shkolla 9-Vjecare " 1-Qershori "	+			
	Shkolla 9-Vjecare " Musine Kokalari "			+	
	Shkolla 9-Vjecare " Kongresi i Manastirit "			+	
	Shkolla 9-Vjecare " Betim Muço "		+		
Njesia Adm. Nr.7	Shkolla e Mesme "Arben Broci"				
	Shkolla 9-Vjecare "Naim Frasheri "				
	Shkolla 9-Vjecare "Pjeter Budi "			+	
	Shkolla 9-Vjecare "Sabaudin Gabrani "	+			
	Shkolla 9-Vjecare "Dhora Leka "	+			
	Shkolla 9-Vjecare "Gustav Mayer"				
	Shkolla 9-Vjecare "Shkolla Drita Pelinku"				
Njesia Adm. Nr.8	Shkolla e Mesme "Partizani "				
	Shkolla 9-Vjecare "Misto Mame"				
	Shkolla 9-Vjecare "Skender Çaçi"				
	Shkolla 9-Vjecare "4 Deshmoret"				
	Shkolla 9-Vjecare "Siri Kodra"	+			

	Shkolla 9-Vjecare "Shkolla e Kuqe"			+	
Njesia Administrative Nr.9	Shkolla e Mesme "Sami Fraseri"				
	Shkolla 9-Vjecare "Sinan Tafaj "				
	Shkolla 9-Vjecare "Hasan Vogli"				
	Shkolla 9-Vjecare "Lidhja e Prizrenit "				+
	Shkolla 9-Vjecare "Qazim Turdiu "				
	Shkolla 9-Vjecare "7- Marsi"				
	Shkolla 9-Vjecare "Jeronim de Rada"	+			
	Shkolla 9-Vjecare "Servete Maci"		+		
Njesia Adm. Nr.10	Shkolla e Mesme "Qemal Stafa"	+			
	Shkolla e Mesme "Kristoforidhi"				
	Shkolla 9-Vjecare "Avni Rustemi"			+	
	Shkolla 9-Vjecare "Dora D'istia"	+			
	Shkolla 9-Vjecare "Konferenca e Pezes"	+			
Njesia Adm. Nr.11	Shkolla e Mesme "Aleks Buda"				
	Shkolla 9-Vjecare "Ahmet Gashi"				
	Shkolla 9-Vjecare "28- Nentori"			+	+
	Shkolla 9-Vjecare "Isa Boletini"				
	Shkolla 9-Vjecare "Kol Jakova"			+	
	Shkolla 9-Vjecare "Skender Luarasi"				
	Shkolla 9-Vjecare "Gjerg Fishta"			+	